FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 92	2002	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 634, datë 13.12.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 236, datë 6.6.1994 të Këshillit të Ministrave "Për tarifat e kullotjes në fondin kullosor të kullotave e pyjeve në administrim të drejtorive të shërbimit pyjor e të kullotave dhe të komunave"…….	2717
Vendim i KM nr. 635, datë 13.12.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 605, datë 13.10.2001 të Këshillit të Ministrave "Për kurset e formimit profesional, të kualifikimit e specializimit në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari""…….	2717
Vendim i KM nr. 642, datë 13.12.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 636, datë 8.10.1998 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Komitetit Shqiptar për lehtësimin e procedurave të tregtisë së jashtme, ALBA-PRO"……..	2718
Vendim i KM nr. 648, datë 13.12.2002	Për ndalimin e përkohshëm të prerjes së lëndëve drusore, me përjashtim të asaj që përdoret për dru zjarri…….	2718
Vendim i KM	Për përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm nga	

nr. 654, datë 18.12.2002	organet shtetërore, në situata emergjente, të çdo mjeti privat……	2719
Vendim i KM nr. 656, datë 18.12.2002	Për njësimin e funksioneve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit me funksionet respektive të Policisë së Shtetit……	2721
Vendim i KM nr. 657, datë 18.12.2002	Për një ndryshim në Rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë"……	2722
Vendim i KM nr. 658, datë 18.12.2002	Për fillimin e procedurës së dhënies me koncension në formën "ROT", të hidrocentraleve vendore Lenie, Çorovodë, Tuçep……	2724
Vendim i KM nr. 659, datë, 18.12.2002	Për krijimin e Institutit të Mjedisit……..	2724
Vendim i KM nr. 663, datë 18.12.2002	Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e Komisionit Teknik Këshillimor të specialistëve për emergjencat civile…….……	2725
Vendim i KM nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare ……	2727
Vendim i KM nr. 677, datë 20.12.2002	Për nënshkrimin e aksioneve shtesë të Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Agjencisë së Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA)……	2737
Vendim i KM nr. 681, datë 20.12.2002	Për krijimin, shtrirjen territoriale dhe klasifikimin e zonave doganore në vendkalimet kufitare Muriqan, Bashkim Vermosh dhe Tri Urat…….	2737
Vendim i KM nr. 682, datë 20.12.2002	Për miratimin e protokollit të bisedimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2002……	2738
Vendim i KM nr. 692, datë 27.12.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 288, datë 18.6.1999 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë"…….	2746
Vendim i KM nr. 695, datë 27.12.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave "Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike ushtarake të rëndësisë së	2747

V E N D I M
Nr. 634, datë 13.12.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 236, DATË 6.6.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TARIFAT E KULLOTJES NË FONDIN KULLOSOR TË KULLOTAVE E PYJEVE NË ADMINISTRIM TË DREJTORIVE TË SHËRBIMIT PYJOR E TË KULLOTAVE DHE TË KOMUNAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 7917, datë 13.4.1995 "Për kullotat dhe livadhet", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 236, datë 6.6.1994 të Këshillit të Ministrave, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Tarifat e kullotjes së bagëtive në fondin kullosor të kullotave e të pyjeve në administrim të drejtorive të shërbimit pyjor e të kullotave dhe të komunave të jenë si më poshtë vijon:

Nr.	Lloji i bagëtive	Tipi i kullotës	
		Dimërore Lek/krerë	Verore Lek/krerë
1.	Dhen	300	200
2.	Dhi	300	200
3.	Të trasha	1200	800

".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 635, datë 13.12.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 605, DATË 13.10.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL, TË KUALIFIKIMIT E SPECIALIZIMIT NË AKADEMINË E POLICISË "ARBEN ZYLYFTARI""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 pika 4, 63, pika 5 të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të neneve 10 pika 1, 12, pika 2, 13, pika 2, 15, pika 3 dhe 16 të ligjit nr. 8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 605, datë 13.10.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "a" e pikës 3.2 ndryshohet si vijon:

"a. Për rolin bazë: - Nga agjent i parë në asistent dhe nga asistent i parë në kryeasistent nga 1 deri në 2 javë.".

2. Shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 3.3 ndryshohen si më poshtë vijon:

"a. Për rolin bazë nga 1 deri në 6 javë.

b. Për rolin e mesëm nga 1 deri në 4 javë.

c. Për rolin e lartë nga 1 deri në 2 javë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 642, datë 13.12.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 636, DATË 8.10.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHQIPTAR PËR LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE TË TREGTISË SË JASHTME, ALBA-PRO"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushteteutës dhe të neneve 121, 124 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 2 të vendimit nr. 636, datë 8.101998 të Këshillit të Ministrave, emërtimi "Zëvendësministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë" zëvendësohet me "Presidenti i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 648, datë 13.12.2002

PËR NDALIMIN E PËRKOHSHËM TË PRERJES SË LËNDËVE DRUSORE, ME PËRJASHTIM TË ASAJ QË PËRDORET PËR DRU ZJARRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 e 22 të ligjit nr. 7623, datë 13.10.1992 "Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndalimin e prerjes së lëndëve drusore, për një periudhë të pacaktuar kohe, me përjashtim të asaj që rezulton nga trajtimi i pyjeve, me punime të detyrueshme përmirësimi, dhe i parcelave për prodhimin e druve të zjarrit.

2. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e procedurave të furnizimit të banorëve të zonave rurale me dru zjarri, lëndë ndërtimi dhe gjeth për blegtorinë, për nevojat vetjake.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 654, datë 18.12.2002

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PËRDORIM TË PËRKOHSHËM NGA ORGANET SHTETËRORE, NË SITUATA EMERGJENTE, TË ÇDO MJETI PRIVAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 pika 2, 31, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile" dhe të nenit 37 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm nga organet shtetërore, në situata emergjente, të çdo mjeti privat, si më poshtë vijon:

a) Strukturat operative të emergjencave civile, në situata emergjente, kanë të drejtë të marrin në përdorim të përkohshëm çdo mjet privat, kundrejt pagesës, sipas tarifave të përcaktuara në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Për mjetet e tjera, që nuk janë përmendur në këtë shtojcë, llogaritjet të bëhen sipas fuqisë dhe tonazhit të tyre.

Llogaria bëhet duke shumëzuar vlerën në tabelë me koeficientin k=1,2 kur fuqia/tonazhi është më e/i madh dhe e kundërta. Për mjetet e transportit e materialeve të përdoret tabela për ton/km, kurse për mjetet stacionare fuqia në kw.

c) Kur strukturat operative të emergjencave civile, për mjetet që marrin në dispozicion, përballojnë karburantin nga rezervat e veta, atëherë tarifa llogaritet në bazë të orëve të punës për manovratorin, plus konsumin e pjesëve të ndërrimit (në rast komsumi), plus 10 për qind, si më poshtë vijon:

T=(m+0,2m)+10%; ku T – tarifa; m – pagesa për një orë pune për manovratorin. Koeficienti m=120 deri 160 lekë, në varësi të tonazhit/fuqisë së mjetit. Kufiri minimal për tonazhin/fuqinë më të ulët dhe e kundërta.

ç) Kur merren mjete në dispozicion për transportin e udhëtarëve, si: autobusë, mikrobusë, etj. tarifat janë të njëjta me ato të udhëzimit të përbashkët nr. 373/1, datë 24.3. 1998 të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe nr. 99/3, datë 24.3.1998 të Ministrisë së Financave.

2. Mjetet merren në përdorim të përkohshëm, sipas aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet drejtuesve të operacionit ose përfaqësuesve të autorizuar prej tyre, për përballimin e situatave emergjente, për aq kohë sa është e domosdoshme, por jo më vonë sesa koha e përfundimit të emergjencës.

3. Shpenzimet që rezultojnë nga përdorimi i përkohshëm i mjeteve private, në raste të situatave emergjente, të përballohen nga burimet financiare të institucionit, të siguruara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

SHTOJCA
TARIFAT PËR MJETET TRANSPORTUESE VETËLËVIZËSE

Tabela 1

Nr.	Largësia e transportit	Km	Ton/km	Në lekë
1	Transporti deri në	0,2	-:-	40
2	Transporti deri në	0,5	-:-	30
3	Transporti deri në	1	-:-	25
4	Transporti deri në	2	-:-	22
5	Transporti deri në	3	-:-	20
6	Transporti deri në	4	-:-	18
7	Transporti deri në	5	-:-	17
8	Transporti deri në	6	-:-	16
9	Transporti deri në	7	-:-	15

10	Transporti deri në	8	-:-	14,5
11	Transporti deri në	9	-:-	14
12	Transporti deri në	10	-:-	12,8
13	Transporti mbi	10	-:-	12
14	Autoambulancë	1,5	-:-	20
15	Sheverlet	1,5	-:-	15

TARIFAT PËR MJETET NGRITËSE

Tabela 2

Nr.	Emërtimi i mjetit ngritës	Aftësia ngritëse në ton	Lek/orë
1	Autovinç	1,5	890
2	Autovinç	5	1500
3	Autovinç	8	1750
4	Autovinç	10	1900
5	Autovinç	16	2100
6	Autovinç	20	3000
7	Autovinç	mbi 20	3500

MJETE GËRMIMI

Tabela 3

Nr.	Emërtimi i mjetit	Njësia matëse	Kapaciteti	1 orë/pune	Në lekë
1	Fadromë "UNK 320"	-		-:-	4500
2	Buldozer DT – 54	-		-:-	1408
3	Buldozer DT – 75	-		-:-	1502
4	Buldozer S 80 – 100	-		-:-	2203
5	Buldozer S – 150	-		-:-	2890
6	Buldozer S – 350 HP	-		-:-	3426
7	Eksavator	m3	0,15	-:-	1220
8	Eksavator	m3	0,25	-:-	1391
9	Eksavator	m3	0,35	-:-	1409
10	Eksavator Varinski	m3	0,4	-:-	1511
11	Eksavator Varinski	m3	0,5	-:-	2225
12	Eksavator Varinski	m3	1-1,25	-:-	2673
13	Eksavator Varinski	m3	2	-:-	3567
14	Fadromë Volvo	-		-:-	3607
15	Motopompa "Gaz 51"	L/min		-:-	1500
16	Motokompresor	m3/sek		-:-	2000
17	Motogjenerator	kw	40	-:-	2000
18	Motogjenerator	kw	68	-:-	2500
19	Zjarrfikëse	ton	9	-:-	3500

V E N D I M
Nr. 656, datë 18.12.2002

PËR NJËSIMIN E FUNKSIONEVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT ME FUNKSIONET RESPEKTIVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 pika 6 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Njësimin e funksioneve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit (PMNZSH) me funksionet respektive të Policisë së Shtetit, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

TABELA NR. 1

Nr.	Funksioni në PMNZSH	Funksioni në Policinë e Shtetit
1	Drejtor i drejtorisë së PMNZSH-së në MPVD	Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit
2	Përgjegjës sektori në Drejtorinë e MNPZSH-së Shef i qendrës së trajnimit të PMNZSH-së	Shef sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit
3	Përgjegjës i qendrës operacionale	Shef zyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit
4	Specialist në Drejtorinë e PMNZSH-së, specialist në qendrën operacionale, instruktor në qendrën e trajnimit	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit
5	Shef sektori i PMNZSH-së në Prefekturën e Qarkut Tiranë	Shef sektori në Drejtorinë e Policisë Tiranë
6	Shef sektori i PMNZSH-së të Prefektit të Qarkut Shkodër, Korçë, Vlorë, Elbasan, Durrës, Fier, Dibër, Kukës, Lezhë, Gjirokastër, Berat	Shef Sektori në Drejtorinë e Policisë së prefekturave në qarqe (respektivisht) Kat.I ose II
7	Shef i PMNZSH-së së rrethit, rajonit, në objekte me rëndësi ekonomike, instruktor i qendrës së trajnimit të PMNZSH-së	Shef seksioni, të drejtorive të Policisë së Shtetit në prefekturat e qarqeve (respektiv.) kat.I ose kat.II
8	Komandant stacioni i PMNZSH-së (oficer)	Komandant reparti policie në komisariatet e policisë (respektiv.) kat.I ose II
9	Inspektor i profilaksisë së PMNZSH-së (oficer)	Inspektor në komisariatin e policisë
10	Komandant stacioni i PMNZSH-së (polic)	Komandant poste policie
11	Inspektor i profilaksisë së PMNZSH-së (polic)	Inspektor zone i Policisë së Shtetit
12	Komandant turni (polic)	Komandant skuadre, sig.objekti
13	Kujdestar-magazinier	Kujdestar-magazinier në komisariat
14	Personel shërbimi i informacionit	Trup për sigurimin e komisariatit
15	Teknik mirëmbajtjeje	Teknik elektronik për aparaturat
16	Personel shërbimi	Trup shërbimi, punonjës patrulle, funksione të barasvlefshme me to

V E N D I M
Nr. 657, datë 18.12.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË RRREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100, pika 2 të kushtetutës dhe të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Neni 292 i Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 292
Modeli dhe karakteristikat e lejes së drejtimit (Neni 115 i Kodit Rrugor)

1. Leja për drejtimin e motomjeteve dhe të automjeteve është në përputhje me modelin evropian dhe ka përmasat e mëposhtme:

a) lartësia 86.0 mm

b) gjerësia 54.0 mm

Karakteristikat e tjera janë shënuar në modelin IV 2/A, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Për të shmangur rreziqet e falsifikimit të lejes së ndërtimit, ajo të prodhohet me material plastik, polikarbonat dhe me elemente të larta sigurie.

3. Karakteristikat e materialit, që përdoret për lejen e drejtimit, elementet e sigurisë së lartë kundër falsifikimit, mënyra e plotësimit të lejes së drejtimit dhe hollësi të tjera të nevojshme përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

4. Vendimet nr. 278, datë 20.6.2002 dhe nr. 375, datë 23.7.2002 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 658, datë 18.12.2002

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCENSION, NË FORMËN “ROT”, TË HIDROCENTRALEVE VENDORE LENIE, ÇOROVODË, TUÇEP

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 9 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”, të nenit 2 të ligjit nr. 8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së dhënies me koncension të hidrocentraleve vendore shoqërisë “EMIKEL”, sh.p.k., Elbasan, sipas propozimit të pakërkuar, si më poshtë vijon:

- Lenie, në rrethin e Gramshit;
- Çorovodë, në rrethin e Skraparit;
- Tuçep, në rrethin e Bulqizës.

2. Forma e koncensionit të jetë “ROT” (rehabilitim, operim, transferim).

3. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë të jenë organi shtetëror i autorizuar (OSHA) për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës koncensionare.

Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 659, datë, 18.12.2002

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", ndryshuar me ligjin nr. 8401, datë 9.9.1998, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i

Ministrave

V E N D O S I:

1. Instituti i Studimeve dhe i Projektimeve të Teknologjisë Kimike, në varësi të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, shndërrohet në Institutin e Mjedisit, në varësi të Ministrit të Mjedisit.

2. Zyrat dhe mjediset e Institutit të Studimeve dhe të Projektimeve të Teknologjisë Kimike, baza materiale, laboratorët, arkivat dhe struktura organizative i kalojnë në administrim Ministrisë së Mjedisit, për krijimin e Institutit të Mjedisit.

3. Instituti i Mjedisit, në bazë të objektivave të përcaktuar nga Ministri i Mjedisit, zhvillon veprimtarinë e vet, në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera shkencore dhe OJF-të mjedisore, në këto drejtime kryesore:

- Në përpunimin e programeve e të planeve të veprimit për mbrojtjen e mjedisit.
- Në zbatimin e programit të monitorimit të gjendjes së mjedisit.
- Në hartimin e metodikave e të metodologjive bashkëkohore, për monitorimin dhe auditimin mjedisor.
- Në zbatimin e projekteve mjedisore.
- Në verifikimin e saktësisë së të dhënave, për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë me ndikim në mjedis. Laboratori i këtij instituti do të shërbejë si laborator reference.

4. Instituti i Mjedisit financohet nga Ministria e Mjedisit, nga Buxheti i Shtetit, miratuar për këtë ministri, për studime e projektime të miratuara.

5. Instituti i Mjedisit kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe angazhohet në projekte të fushës së tij, me kërkesën e personave juridikë dhe fizikë, publikë a privatë, vendas a të huaj, me anë të kontraktimeve ligjore, të miratuara nga Ministri i Mjedisit, kundrejt një pagese, tarifa e së cilës përcaktohet me akte të veçanta. Të ardhurat e krijuara administrohen nga Instituti i Mjedisit, sipas kritereve të përcaktuara në vendimin nr. 424, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".

6. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 663, datë 18.12.2002

PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT TEKNIK KËSHILLIMOR TË SPECIALISTËVE PËR EMERGJENCAT CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 10 të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni Teknik Këshillimor të ketë në përbërje përfaqësues si më poshtë vijon:

A. Nga Këshilli i Ministrave:1
B. Nga ministritë:

- Ministria e Mbrojtjes	2
- Ministria e Shëndetësisë	2
- Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	2
- Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit	2

- Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit	2
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	1
- Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	1
- Ministria e Mjedisit	1
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1
- Ministria e Financave	1
- Ministria e Drejtësisë	1
- Ministria e Ekonomisë	1
- Ministria e Punëve të Jashtme	1
- Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale	1
- Ministria e Rendit Publik	1

C. Nga institucione shkencore dhe monitoruese:

- Akademia e Shkencave	1
- Sekretariati Shtetëror i Digave të Larta	1
- Universiteti Politeknik i Tiranës	3
- Instituti i Sizmiologjisë	1
- Instituti i Hidrometeorologjisë	1
- Instituti i Fizikës Bërthamore	1
- Instituti i Shëndetit Publik	1
- Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë	1
- Instituti i Kërkimeve Veterinare	1
- Instituti i Kërkimeve Ushqimore	1
- Instituti i Pyjeve dhe Kullotave	1
- Instituti i Studimeve për Transportin	1
- Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit	1
- Qendra e Studimeve Gjeografike	1
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	1
- KESH	1

Ç. Nga Kryqi i Kuq, OJF-të dhe agjencitë e OKB-së:

- Kryqi i Kuq Shqiptar1
- Koordinatori rezident i OKB-së në Shqipëri1
- Organizatat jofitimprurëse1

2. Mënyra e funksionimit të Komisionit Teknik Këshillimor

a. Komisioni Teknik Këshillimor thërritet dhe drejtohet nga drejtori i Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, sa herë që ai e gjykon të nevojshme, por jo më pak se një herë në tre muaj.

b. Anëtarët e komisionit, përveç takimeve të rregullta, duhet të jenë të gatshëm për të marrë pjesë dhe të angazhohen në detyra të veçanta individuale dhe në grupe, që kërkohen nga komisioni teknik.

c. Përfaqësuesit e përmendur në shkronjën "A" janë anëtarë të përhershëm të komisionit, përfaqësuesit e përmendur në shkronjën "B", përjashtuar atë të Akademisë së Shkencave, ftohen në varësi të nevojave, ndërsa përfaqësuesit e përmendur në shkronjën "C" janë vëzhgues të përhershëm.

ç. Për përfaqësuesit e përmendur në shkronjën "A", niveli i përfaqësimit të jetë nënkryetar i komisionit të emergjencave civile, në nivel drejtor drejtorie ose të barazuar me ta, ndërsa për përfaqësuesit e përmendur në shkronjat "B" dhe "C" drejtues institucioni, agjencie OSE shoqate.

d. Drejtori i Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile përgjigjet për përgatitjen e materialeve dhe për njoftimin për mbledhjen e radhës së komisionit, duke ia dërguar, çdo anëtari, jo më vonë se 10 ditë përpara datës së mbledhjes.

dh. Pranë Komitetit Teknik Këshillimor funksionon sekretaria teknike, me punonjës të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

e. Drejtori i Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, për probleme të veçanta të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile, i propozon Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, ngritjen e grupeve të përkohshme të punës, me objekt dhe afate të përcaktuara, me punonjës të brendshëm ose nga jashtë ministrisë.

ë. Ministri, me propozimin e drejtorit të departamentit, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore, në fuqi, përcakton mënyrën dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të komisionit dhe të

sekretarisë për punën e kryer shtesë, jashtë detyrave të tyre.

3. Komisioni Teknik Këshillimor ka përgjegjësi:

a. të përgatisë strategjinë, politikat dhe programet në fushën e mbrojtjes civile, shëndetin publik, pasurinë, vlerave kulturore dhe mjedisit rrethues nga ndikimet e emergjencave civile;

b. të përgatisë dhe të zhvillojë programe edukimi për strukturat e emergjencave dhe publikun e gjerë në fushën e mbrojtjes civile;

c. të zhvillojë, të parashikojë dhe të përditësojë materialin e rreziqeve, si dhe të vlerësojë mundësitë për përballimin e tyre;

ç. të përpunojë planet për përballimin e emergjencave civile, të përgatitura nga institucionet shtetërore e jo shtetërore, dhe t'i përfshijë ato në Planin Kombëtar të Përballimit të Emergjencave Civile;

d. të mbikëqyrë dhe të ndihmojë në ngritjen e sistemit kombëtar të Emergjencave Civile, si dhe në vënien në eficencë të plotë të tyre;

dh. të përgatisë modele dhe skenare për stërvitjen e trupave operacionale të shërbimit të emergjencave civile dhe për nivele të ndryshme të qeverisjes, vendore e qendrore;

e. të ofrojë rrugët e zgjidhjes për masat parandaluese dhe të rehabilitimit për lloje të ndryshme fatkeqësish natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, para, gjatë dhe pas situatave emergjente;

ë. të ndërmarrë nisma dhe studime për pakësimin e dëmit dhe të efekteve të tjera negative, që mund të vijnë si rezultat i emergjencave civile;

f. të përgatisë dhe të zhvillojë projektin e integruar të komunikimit me sinjal 112, në të gjithë sistemin e emergjencave civile.

4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

5. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 676, datë 20.12.2002

PËR SHPALLJEN ZONË E MBROJTUR TË MONUMENTEVE TË NATYRËS SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 7 dhe 13 të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 100, datë 19.5.1981, "Për vënien nën mbrojtjen shtetërore të pasurive natyrore të rralla", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, strukturat e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, e Kullotave dhe Drejtoria e Peshkimit, si dhe organet e qeverisjes vendore, ku ndodhen këto monumente të natyrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 677, datë 20.12.2002

PËR NËNSHKRIMIN E AKSIONEVE SHTESË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KAPITALIN E AGJENCISË SË GARANTIMIT TË INVESTIMEVE SHUMËPALËSHE (MIGA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr. 7515, datë 1.10.1991 "Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikteve në Investime", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nënshkrimin e 44 aksioneve shtesë, me vlerë 476. 080 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë) USD, të Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Agjencisë së Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA). Nga kjo shtesë 84. 028 (tetëdhjetë e katër mijë e njëzet e tetë) USD ose 17.65 për qind të jenë të pagueshme në cash, ndërsa pjesa tjetër prej 392. 052 (treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëdhjetë e dy) USD ose 82.35 për qind e shtesës të përbëjnë kapitalin e thirrur.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të përballojë fondet e nevojshme për pagesën e aksioneve shtesë, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e Guvernatorit të MIGA-s për Republikën e Shqipërisë, të kryejë, në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë, të gjitha procedurat e nevojshme për pagesën e aksioneve shtesë në kapitalin e MIGA-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 681, datë 20.12.2002

PËR KRIJIMIN, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE KLASIFIKIMIN E ZONAVE DOGANORE NË VENDKALIMET KUFITARE MURIQAN, BASHKIM VERMOSH DHE TRI URAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 pika 3 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e zonës doganore të përhershme në vendkalimet kufitare Muriqan dhe Bashkim Vermosh, në kufirin tokësor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Malit të Zi.

2. Krijimin e zonës doganore të përhershme në vendkalimin kufitar Tri Urat, në kufirin tokësor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Greqisë.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 682, datë 20.12.2002

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK PËR VITIN 2002

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e protokollit të bisedimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik, për vitin 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROTOKOLL
I BISEDIMEVE MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR VITIN 2002

Në datat 18 deri 20 nëntor 2002 u zhvilluan në Tiranë bisedimet qeveritare mbi bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2002 midis delegacionit të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe delegacionit të Qeverisë së Republikës Shqiptare.

Delegacioni gjerman drejtohej nga zoti Dr. Leo Kreuz, shef seksioni në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Për delegacionin shqiptar bisedimet u drejtuan nga Zëvendësministrja e Ekonomisë, zonja Adriana Berberi.

Lista e pjesëmarrësve të dy delegacioneve ndodhet bashkëngjitur në shtojcë.

Bisedimet u zhvilluan në një atmosferë të hapur dhe konstruktive dhe u karakterizuan nga një mirëkuptim reciprok.

Kryetarja e Delegacionit Shqiptar përshëndeti miqtë gjermanë dhe i deklaroi të hapura bisedimet qeveritare.

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Në radhë të parë dëshiroj të deklaroj të hapur bisedimet ndërqeveritare për vitin 2002 dhe i uroj mirëseardhjen delegacionit gjerman. Dëshiroj, me këtë rast, që të falënderoj për ndihmën ndërshtetërore që Gjermania i ka dhënë dhe i jep vendit tonë, në kuadër të bashkëpunimit financiar dhe teknik. Po ashtu, ne vlerësojmë përpjekjet e Qeverisë Gjermane për iniciativat që ajo ka ndërmarrë dhe ndërmerr në kuadër të Paktit të Stabilitetit për sensibilizimin e shteteve ekonomikisht të zhvilluara dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare, për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe institucional të Shqipërisë, në kuadër të procesit të asociim-stabilizimit. Shqipëria vazhdon të ketë nevojë për mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe të komunitetit të donatorëve. Në saje të ndihmës të madhe financiare nga jashtë dhe të reformave të vazhdueshme të marra nga Qeveria Shqiptare, ka stabilizuar zhvillimin e gjithanshëm të vendit. Shqipëria është e vendosur që të vazhdojë në rrugën e forcimit të kapaciteteve qeverisëse, me qëllim përgatitjen dhe implementimin për integrimin në strukturat evropiane. Struktura qeverisëse dhe institucionet janë në një proces të vazhdueshëm reformimi.

Gjermania, si donatorja kryesore në Shqipëri, ka ndihmuar dhe mbështetur procesin e gjatë të integrimit të Shqipërisë në familjen evropiane, duke kontribuar dhe mbështetur sektorë të tillë të rëndësishëm të zhvillimit kombëtar. Në kuadrin e bashkëpunimit teknik midis dy qeverive tona,

Qeveria Shqiptare e konsideron shoqërinë civile si një element qenësor për konsolidimin e shoqërisë shqiptare dhe demokratizimin e kolegjialitetin e qeverisjes. Në nivele konkrete, ky bashkëpunim synon rritjen e formës së promovimit të demokracisë, decentralizimin e pushtetit lokal, dialogun, bashkëpunimin në fushën e mediave, zhvillimin e arsimit, minoritetet etj. Shqipëria duhet të angazhohet më tepër në kuadrin e përgatitjeve të saj për integrimin në Evropë. Kjo kërkon përgatitjen e strategjive në fushat e ekonomisë, përgatitjen dhe harmonizimin e legjislacionit, kryerjen e reformave në administratën publike, trajnimin në vendet e BE-së etj. Duke përfunduar, shpreh edhe një herë bindjen time më të thellë se ky bashkëpunim i frytshëm dhe konkret, si dhe fryma e ngrohtë dhe miqësore që ekziston midis dy vendeve tona do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi Shqipëria sheh te Republika Federale Gjermane mikun dhe partnerin e saj më të fuqishëm.

Kryetari i delegacionit gjerman falënderoi Zëvendësministren e Ekonomisë dhe delegacionin shqiptar për fjalët e përzemërta përshëndetëse dhe analizën e hollësishme të bashkëpunimit dypalësh. Nisur nga fakti se në vitet e fundit ka ardhur shpesh në Shqipëri me rastin e bisedimeve për bashkëpunimin dypalësh, ai shprehu bindjen se bashkëpunimi do të vazhdojë mbi këtë bazë të fortë. Njëkohësisht, kryetari i delegacionit gjerman shprehu kënaqësinë se ka gjetur te zonja Zëvendësministre një eksperte me përvojë në fushën ekonomike dhe financiare.

Duke i hedhur një vështrim traditës së gjatë të bashkëpunimit, nisur që në vitin 1988, ai nënvizoi gatishmërinë e Qeverisë Gjermane për vazhdimin e saj. Më tej, ai siguroi se Gjermania do të vazhdojë të mbështesë aktivisht Shqipërinë në procesin e përafrimit me Bashkimin Evropian nëpërmjet projekteve për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Në mënyrë që imazhi i Shqipërisë në Evropë të përmirësohet gjithnjë e më shumë, është e nevojshme që politika shqiptare të punojë më tej për mirëqenien e popullsisë. Bashkëpunimi dypalësh synon të mbështesë Shqipërinë në procesin e stabilizim-asocimit në Bashkimin Evropian. Ky proces ndikon ndjeshëm në politikën e palës shqiptare; pjesë e tij është dhe decentralizimi i mëtejshëm në vend. Në kuadër të projekteve të saj pala gjermane mbështet krijimin e kapaciteteve përkatëse të njësive të pushetit vendor, si dhe Qeverinë Shqiptare për përshtatjen dhe thjeshtimin e procedurave administrative. Procesi i decentralizimit do të tërheqë dhe investimet private. Një shembull pozitiv është përfshirja e sektorit privat në kuadër të projektit për ujësjellësin dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Elbasan, ku është angazhuar dhe një investitor gjerman. Ky duhet të shërbejë si shembull dhe për projekte në qytete dhe sektorë të tjerë.

Bashkëpunimi dypalësh mbështetet në besimin reciprok dhe rregulla të caktuara, në mënyrë që të krijohet transparenca e nevojshme për përdorimin e mjeteve financiare. Zgjidhjet e përcaktuara gjatë këtyre bisedimeve qeveritare janë të realizueshme vetëm nëse ato zbatohen duke respektuar qëllimet e bashkëpunimit.

Në mbyllje të fjalës përshëndetëse, kryetari i delegacionit gjerman falënderoi për përgatitjen profesionale të bisedimeve, gjë që dëshmon dhe një herë se sa i gjerë dhe gjithëpërfshirës është bashkëpunimi dypalësh.

Të dyja palët përkrahin fuqimisht fushat e rëndësishme të bashkëpunimit:

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet: energjetika, reformën ekonomike/ngritja e ekonomisë së tregut, të cilat, nëpërmjet ndikimit të tyre në grupet e varfra të popullsisë, do të japin një kontribut të veçantë në politikën e luftës kundër varfërisë në kuadrin e Program-Aksionit 2015 të Qeverisë Federale Gjermane. Kryetari i delegacionit gjerman shpjegoi se në kuadër të buxhetit federal për vitin 2002 janë vënë në dispozicion mjete financiare në shumën e 15.65 milion eurove për ndihmesën e bashkëpunimit tekniko-financiar. Për këtë vit do të akordohen shumë pak mjete financiare shtesë, sikurse janë akorduar vitet e mëparshme nga fondi i Paktit të Stabilitetit, pasi ky fond pothuajse është shpenzuar krejtësisht.

Bashkëpunimi financiar (BF)

1.1. Bashkëpunimi aktual dhe aspektet themelore të tij

Në lidhje me çështje të bashkëpunimit aktual financiar, si dhe të aspekteve themelore ose të përgjithshme, u bisedua me hollësi rreth çështjeve të mëposhtme:

1.1.1.Të përgjithshme

Të dyja palët ishin dakord në lidhje me nevojën për t'i kufizuar minimalisht periudhat paraprake administrative për projektet e bashkëpunimit financiar. Në këtë kuadër pika të rëndësishme janë nënshkrimi i menjëhershëm i marrëveshjeve qeveritare, kontratave të huave dhe të financimit, si dhe paraqitja në kohë e bazës ligjore, si për shembull i vendimeve të Parlamentit ose vlerësime të Ministrisë së Drejtësisë. Në raste urgjente, si përjashtim, mund të realizohet parafinancimi i projekteve

me mjete financiare nga fondi për studime dhe ekspertë.

Të dy palët diskutuan rreth propozimit të fundit të palës shqiptare lidhur me ndryshimin e procedurës së deritanishme për disbursimin e fondeve të bashkëpunimit financiar. Pala gjermane propozoi që të ruhet forma e deritanishme për këto procedura. Lidhur me këtë pala shqiptare deklaroi se përdorimi i procedurave të thesarit në procesin e disbursimit të fondeve të financuara në kuadrin e bashkëpunimit financiar jo vetëm që nuk sjell asnjë pengesë në implementimin e projektit, por është një domosdoshmëri në bazë të legjislacionit përkatës shqiptar. Këto procedura janë procedurat që përdoren për fondet e financuara në formën e kredive/granteve nga donatorë të tjerë. Gjithashtu, përdorimi i këtyre procedurave është dhe një nga kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Shqipërisë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Të dyja palët ranë dakord që të shkëmbejnë informacione për të krijuar një pamje të qartë.

Pala shqiptare siguroi nënshkrimin e menjëhershëm të kalimit formal të të drejtave dhe detyrimeve, që dalin nga kontratat e huave dhe financimit të lidhura me Bankën e Shqipërisë deri në vitin 1999, Ministrisë së Financave, si dhe njoftimin e KFW-së (Bankës për Rindërtim) për afatin e nënshkrimit.

1.1.2 Sektori i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave të zeza

Të dyja palët ishin dakord me faktin se procedura e deritanishme për transferimin e përgjegjësisë së projektit me anë kontratash mbi ndërmarrjet vendore të ujësjellësve, ishte e drejtë e për këtë arësye duhet të vazhdojë të ruhet në formën e deritanishme. Kjo praktikë duhet të vlejë dhe për projekte të ardhshme që përfshijnë sektorin privat.

Pala gjermane theksoi rishtaz rëndësinë e ecurisë së pandërprerë të procesit të decentralizimit, në mënyrë të veçantë rëndësinë e hartimit të shpejtë të dispozitave nënligjore. Lidhur me ecurinë e këtij procesi pala shqiptare deklaroi se kohët e fundit Këshilli i Ministrave miratoi politikat e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Kështu janë krijuar kushtet për kalimin e kompetencave.

Përsa i përket masave në lidhje me bisedimet/konsultimet në nivel qeveritar për çështjen e bordeve mbikëqyrëse, trajtimit të borxheve të trashëguara të ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe rregullimit të çështjes së pronësisë së sipërmarrësve të ndërmarrjeve, pala shqiptare bëri të ditur hapat e ndërmarra në periudhën e ndërmjetme dhe deklaroi se brenda vitit 2002 do të evidentohen inventari i ujësjellësave dhe do të përcaktohen organet e qeverisjes vendore, të cilave do t'u transferohen këto të drejta pronësie.

Duke marrë parasysh kuadrin e ri ligjor të krijuar në Shqipëri, mjetet financiare të parashikuara për trajnimin e stafit të Entit Rregullator të Ujit, duhet të përdoren si për Entin Rregullator, ashtu edhe për Shoqatën e Ujësjellësve të Shqipërisë. Termat e referencës për mbështetjen e Entit Rregullator do të përshtaten në mënyrë të tillë që ato të reflektojnë kuadrin e ndryshuar ligjor. Ky program kualifikimi, i cili zbatohet nga Shoqata Shqiptare e Ujësjellësve ka për qëllim t'u sigurojë punonjësve dhe administratave lokale kompetencën që u nevojitet për realizimin e detyrave të reja në kuadër të procesit të decentralizimit.

Pala gjermane theksoi se e konsideron si veçanërisht të rëndësishme një ent kombëtar rregullues për sektorin e ujësjellësit, në mënyrë që të sigurohen shërbimet përkatëse për furnizimin e qëndrueshëm me ujë të popullsisë. Për këtë arsye duhet që, brenda vitit 2002, të nënshkruhet kontrata për mbështetjen e Entit Rregullator duke mbajtur parasysh kuadrin ligjor përkatës.

Në mënyrë të veçantë u diskutuan projektet në zbatim e sipër në këtë sektor:

Ujësjellësi Elbasan: Të dy palët janë të mendimit se zbatimi i suksesshëm i Projektit përbën një sinjal të qartë pozitiv për investitorë të tjerë potencialë në këtë sektor. është e nevojshme një punë aktive me shtypin dhe publikun si nga ana e pushtetit qendror, ashtu dhe atij vendor, në mënyë që qytetarët të informohen mbi ecurinë në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm. Pala shqiptare konfirmoi gatishmërinë e saj për realizimin e këtij qëllimi.

Ujësjellësi Berat dhe Kuçovë: Pala shqiptare garantoi fillimin e menjëhershëm të hapave të nevojshëm për përgatitjen e mëtejshme të koncesionit - veçanërisht vendimet e nevojshme për përzgjedhjen e të ashtuquajturit "Transaction Adviser". Për më tepër pala shqiptare deklaroi në lidhje me këtë se, është ngritur grupi i negocimit me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, grup i cili do të marrë vendimet e nevojshme brenda vitit 2002.

Ujësjellësi dhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza Kavajë: Pala gjermane vuri theksin në faktin, se nga njëra anë ky Projekt ka për qëllim përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë të

pijshëm në Kavajë dhe nga ana tjetër aftësimin e strukturave përgjegjëse vendore për të menaxhuar ndërmarrjen e ujësjellësit sipas standardeve evropiane. Për këtë arsye përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen e kontratës së menaxhimit duhet ta ketë bordi drejtues i ndërmarrjes, ku një rol të rëndësishëm luajnë autoritetet vendimmarrëse në nivel vendor. Pala shqiptare bëri të ditur se kontrata e menaxhimit do të nënshkruhet brenda tremujorit të parë të vitit 2003.

1.1.3 Sektori energjetik

Pala gjermane përshëndeti ratifikimin e "Planit shqiptar të veprimit për përmirësimin e eficencës teknike dhe administrative" të revizionuar rishtaz për vitin 2002-2003. Ajo bëri të ditur se në dhjetëmujorin e parë të vitit ishin përmbushur objektivat e përcaktuara në lidhje me zvogëlimin e humbjeve dhe rritjen e eficencën thithëse janë arritur falë rezultateve të mira në tremujorin e parë.

Pala gjermane shpreson, që të mos ketë më mosrealizime objektivash, si në tremujorin e tretë gjë e cila do të vinte në rrezik mbështetjen e mëtejshme në sektorin energjetik. Më tej ajo nënvizoi rëndësinë që i jep përfshirjes në të ardhmen të sektorit privat në ekonominë energjetike shqiptare si për shembull në projektet e partneritetit publiko-privat (PPP). Lidhur me këtë çështje pala shqiptare deklaroi, se ajo është duke ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përfshirë sektorin privat në këtë proces.

Në mënyrë të veçantë u diskutuan projektet aktuale në këtë sektor:

Furnizimi me energji në jug të Shqipërisë: Pala gjermane tërhoqi vëmendjen mbi faktin, se duhet të sigurohen të drejtat ujore për furnizimin e të dy hidrocentraleve Bistrica I dhe Bistrica II përpara fillimit të punimeve rehabilituese në fillim të vitit 2003. Në rast të kundërt do të ekzistonte rreziku i burimeve të pamjaftueshme ujore për prodhimin e energjisë elektrike nga të dy hidrocentralet. Qeveria shqiptare garantoi sqarimin e kësaj çështjeje deri në fund të vitit 2002.

Studim rajonal: Të dy palët u shprehën pozitivisht për ecurinë e deritanishme të studimit energjetik rajonal të bërë të njohur nga pala gjermane gjatë konsultimeve qeveritare në muajin maj. Qëllimi i këtij studimi është të sigurojë një vështrim të përgjithshëm mbi zhvillimin e ardhshëm të sektorit energjetik në Evropën Juglindore për periudhën 2002-2015 (përfshirë skemat për zhvillimin e kërkesës si dhe Leas Cost Options për zgjerimin e objekteve të prodhimit e të transmetimit). Rezultatet e studimit do t'i paraqiten për studim komunitetit të investitorëve deri në fund të vitit. Pala shqiptare theksoi, se ajo do t'i përfshinte rezultatet e këtij studimi duke i koordinuar ato me studime të tjera të realizuara ndërkohë nga organizata të ndryshme ndërkombëtare në strategjinë kombëtare për sektorin energjetik.

1.1.4 Sektori i reformës ekonomike/ndërtimi i ekonomisë së tregut

Të dy palët shprehën kënaqësinë e tyre lidhur me bashkëpunimin pozitiv në sektorin financiar për mbështetjen e biznesit më të vogël, të vogël e të mesëm. Ndërkaq është realizuar marrëveshja për administrimin e mjeteve financiare nga programi gjermano-shqiptar për mbështetjen e këtij biznesi. Meqë studimi aktual i fizibilitetit tregon se ndërkohë janë vënë në dispozicion fonde të mjaftueshme nga donatorë të tjerë për përmirësimin e situatës monetare, nuk duhet të vazhdohet më tej ky Projekt nga fondet e bashkëpunimit financiar. Krahas krijimit të mëtejshëm premtues të mikrosigurimeve po merret në konsideratë mundësia për të mbështetur biznesmenë privatë në sektorin bujqësor me fonde të bashkëpunimit financiar nëpërmjet bankës FEFAD.

1.1.5 Projekte të tjera

Aeroporti i Rinasit: Pala zbatuese e Projektit dhe firma ndërtuese kanë rënë dakord për përdorimin e pjesës së mbetur të fondeve prej 0.895 milion euro, ndërkohë mungon miratimi i nevojshëm i palës huamarrëse, Bankës së Shqipërisë. Për këtë arsye fondet janë të bllokuara. Në mënyrë që të sigurohet vazhdimi i mëtejshëm, pala shqiptare garantoi marrjen sa më të shpejtë të një vendimi.

1.2 Premtime të reja

Të dyja palët ranë dakord që me fonde të bashkëpunimit financiar për vitin 2002 në një shumë prej 12.5 milion euro të merret në konsideratë zbatimi i projekteve të mëposhtme:

1.2.1 "Mbrojtja e liqenit të Shkodrës"7.5 Mio euro (Kontribut financiar)

1.2.2 "Furnizimi me ujë të pijshëm/kanalizimet e ujërave të zeza

Shqipëria e Veriut (Bajram Curri)" 5.0 Mio euro (Hua)

Huaja jepet me një përqindje interesi prej 0.75% për një periudhë 40 vjeçare, shlyerja fillon pas 10 vjetësh. Meqë në parim Projekti i përmbush kushtet për sigurimin e një kontributi financiar, në të ardhmen mund të merret në konsideratë mundësia për ta shndërruar kredinë në kontribut financiar.

1.3 Bashkëpunimi në të ardhmen

Në kuadër të fushave të përcaktuara të bashkëpunimit palët ishin dakord për ta vazhduar atë në projektet e mëposhtme:

- Kanalizimet e ujërave të zeza në Korçë:

(Shënim: Fondet e parashikuara në një fazë fillestare për kanalizimet e ujërave të zeza u përdorën për kompletimin e Projektit aktual për furnizimin me ujë të pijshëm. Për financimin e kanalizimeve të ujërave të zeza do të jenë të nevojshme mjete financiare shtesë).

- Përsa i përket propozimeve për kanalizimet e ujërave të zeza në Rrogozhinë do të shqyrtohet mundësia e realizimit të tyre në kuadër të projektit për kanalizimet e ujërave të zeza në Kavajë ose të Projektit për ujësjellësin dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Lushnje ose në formën e një programi rajonal.

- Programi i efikasitetit energjetik për zëvendësimin e energjisë elektrike të përdorur për ngrohje nga sisteme joqendrore ngrohjeje nëpërmjet burimeve të tjera të energjisë.

- Sektori financiar/mikrosigurimet.

- Programi për luftën ndaj varfërisë.

- Heqja e mbetjeve urbane në Jug-Lindje të Shqipërisë.

- Fondi i studimeve dhe ekspertëve.

2. Bashkëpunimi teknik

Të dyja palët kanë rënë dakord në vitin 2001 për pikat e rëndësishme të bashkëpunimit bilateral për zhvillim. Edhe bashkëpunimi teknik orientohet nga këto prioritete. Përveç kësaj ai kontribuon në kuadrin e përafrimit me Bashkimin Evropian.

2.1 Bashkëpunimi në vazhdim

Të dyja palët u shprehën të kënaqura për zbatimin e projekteve aktuale. Në veçanti u diskutuan projektet aktuale të mëposhtme:

2.1.1 Ngritja e një zyre informacioni të kredive

Projekti që financohet nga Fondi për Studime dhe Ekspertë mbështet krijimin e një zyre informacioni për kreditë, si një njësi brenda Bankës së Shqipërisë. Kjo zyrë ose regjistri i kredive siç quhet ndryshe, është një qendër që do të grumbullojë informacion nga të gjitha bankat dhe do t'i furnizojë ato me informacion për klientin duke lehtësuar procesin e vendimmarrjes në rastin e kredidhënies. Krahas këtij financimi nga Qeveria Gjermane për studime dhe asistencë teknike Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të kërkojë asistencën e institucioneve të tjera duke përfshirë këtu edhe Bankën Botërore për financimin e plotë të Projektit.

2.1.2 Mbështetja e praktikës ligjore shqiptare

Në vitin 2001 Projektit iu akorduan rreth 250 000 euro fond shtesë për financimin e një faze të mëtejshme. Për shkak të shpejtësisë së madhe të zbatimit, mund të thuhet që tani se këto fonde do të shpenzohen që në gjysmën e parë të vitit 2003. Aktualisht, Projekti mbështet ndër të tjera përgatitjen e draftit të ligjit të mbrojtjes së konsumatorit, shtesat dhe ndryshimet në ligjin mbi pronësinë industriale dhe shtesat dhe ndryshimet në ligjin mbi kartelat. Orgnizohen kurse kualifikimi për gjyqtarët dhe së fundi është organizuar një shkëmbim profesional ndërmjet noterëve shqiptarë dhe një dhome gjermane noterësh.

Duke marrë parasysh këto zhvillime, të dy delegacionet ranë dakord që në kuadrin e fondit të studimeve dhe ekspertëve të mbështetet më tej plotësimi i ligjeve ekonomike në funskion të përafrimit me BE.

2.2 Akordime të reja

Volumi i përgjithshëm i deritanishëm i bashkëpunimit teknik me Republikën e Shqipërisë arrin 32.3 milion euro. Për vitin 2002 Qeveria Federale i akordon Republikës së Shqipërisë një kontribut të mëtejshëm prej 3.15 milion euro për zbatimin e projekteve të bashkëpunimit teknik.

2.3 Përdorimi i fondeve

Të dy palët janë dakord për përdorimin e akordimeve të reja (pika 2.2) për projektet e mëposhtme:

2.3.1 Këshillim për përafrimin ekonomik me Bashkimin Evropian/Mbështetja e Procesit të Stabilizim Asocimit 0.75 Mio euro

2.3.2 Mbështetja e ekonomisë dhe punësimit në zonat me strukturë të dobët në veri të Shqipërisë nëpërmjet masave për reduktimin e varfërisë1.25 Mio euro

2.3.3 Fondi i studimeve dhe ekspertëve (Fondi aktual) 0.15 Mio euro

Në këtë fond, duke përfshirë dhe akordimet e reja nuk janë shpenzuar ende 750 000 euro.

Dy delegacionet ranë dakord që të financohen masat e mëposhtme:

- Këshillim në plotësimin e disa ligjeve të përzgjedhura ekonomike në drejtim të përafrimit me BE-në.

- Mbështetja e kualifikimeve dhe e SME-ve për të papunët në rajonet e Fierit dhe Beratit.

2.3.4 Fondi i studimeve dhe ekspertëve (i ri)1.0 Mio euro

Dy delegacionet ranë dakord që të financohen masat e mëposhtme:

- këshillim për planifikimin modern të qytetit të Tiranës;

- iniciativa e mbrojtjes së konsumatorit (Struktura publike dhe Shoqëria civile);

- këshillim paraprak në aplikimin e menaxhimit të cilësisë në ekonominë prodhuese;

- këshillim në komercializimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytete.

2.4 Bashkëpunimi i ardhshëm

Të dy delegacionet ranë dakord për të marrë në shqyrtim fushat e mëposhtme të këshillimit dhe mbështetjes për bashkëpunimin e ardhshëm:

- Modernizimi i ekonomisë bujqësore dhe ushqimore si dhe përafrimi i saj drejt Bashkimit Evropian - Shtesë fondesh.

- Forcimi i ekonomisë në rajonin e Korçës dhe Pogradecit nëpërmjet kualifikimeve profesionale.

- Fondi i studimeve dhe ekspertëve - Shtesë fondesh.

3. Format e tjera të Bashkëpunimit teknik

3.1 Ekspertët e integruar

Delegacioni gjerman theksoi se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë është e gatshme të mbështesë Republikën e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të mbuluar nevojat e saj për ekspertë në fusha të rëndësishme të politikave të zhvillimit, ku nuk ka ekspertë vendas. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë: mund të mbështesë rekrutimin e ekspertëve në tregun gjerman të punës dhe t'u sigurojë atyre në kuadrin e mundësive të saj kompensimin e pagës. Momentalisht në Shqipëri veprojnë 4 ekspertë të integruar në fushat: arsimi profesional, bujqësi, mjedis dhe media. Ndërmjetësimi i ardhshëm për ekspertë do të përqendrohet në të ardhmen në fushat për të cilat do të bien dakord dy qeveritë.

Kërkesat për ekspertët e integruar nga institucionet publike dhe private shqiptare duhet t'i drejtohen nëpërmjet Ambasadës Gjermane në Tiranë qendrës "Centrum fur Internationale Migration und Entwicklung (CIM)", Barckhausstr.16, D-60325 Frankfurt am Main.

3.2 Formimi politiko-shoqëror

Delegacioni gjerman vuri në dukje se në Shqipëri veprojnë me mbështetjen financiare të Qeverisë Gjermane fondacioni Friedrich-Ebert, fondacioni Konrad Adenauer dhe fondacioni Hanns Seidel. Përveç kësaj, Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqërisë së Shkollave Popullore, zbaton masa mbështetëse për arsimimin e të rriturve.

3.3 Puna e institucioneve fetare

Kryetari i Delegacionit gjerman informoi se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë mbështet financiarisht edhe punën e institucioneve fetare gjermane në Shqipëri në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim.

3.4 Konsulencë nga shoqata "Snior Expert Service" (SES)

Pala gjermane informoi mbi veprimtarinë e SES-it të mbështetur nga Qeveria Federale Gjermane. Thelbi i këshillimit nga ekspertët në pension të kësaj organizate është zgjidhja e problemeve akute teknike dhe/ose ekonomike në firmat e vogla dhe të mesme të biznesit.

4. Kushte për zbatimin e projekteve

Të dy delegacionet ranë dakord, që të gjithë kontributet e palës gjermane të paraqitura në këtë protokoll (në pikat 1 dhe 2) mund të zbatohen vetëm pasi:

- Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë të ketë marrë një vendim pozitiv pas shqyrtimit të projekteve ose të programeve nga Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW) (Banka për Rindërtim), Deutsche Gesellschaft fur Technische Zusammenarbeit (GTZ) (Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Teknik) dhe/ose një organizatë tjetër e ngarkuar me zbatimin e tyre;

- të jetë siguruar financimi i përgjithshëm i projekt/programit;

- të kenë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare që janë akoma në shqyrtim (marrëveshje qeveritare dhe marrëveshje projekti), si dhe kontratat e financimit, të huasë dhe të zbatimit me KfW-në, GTZ-në dhe, sipas rastit, me organizatat e tjera zbatuese.

5. Klauzolë rezervë

- Pala gjermane vuri në dukje se akordimet e bashkëpunimit financiar (pika 1) dhe të bashkëpunimit teknik (pika 2) shfuqizohen pa zëvendësim, në rast se marrëveshjet e zbatimit d.m.th. përkatësisht marrëveshjet e huasë apo të financimit për bashkëpunimin financiar dhe zakonisht shkëmbimi i notave për bashëpunimin teknik, nuk lidhen brenda 8 viteve pas vitit të akordimit. Për akordimet e vitit 2002 afati mbaron më 31 dhjetor 2010.

- Në rast se një ose disa projekte të përmendura nuk zbatohen ose zbatohen vetëm pjesërisht, ato mund të zëvendësohen me një projekt tjetër apo me projekte të tjera, nëse të dy qeveritë bien dakord për këtë.

Deklaratë

- Pala gjermane përshëndeti masat e marra nga Qeveria Shqiptare për luftën kundër korrupsionit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria Federale Gjermane shprehën të njëjtin vlerësim se korrupsioni dëmton qeverisjen e mirë, shpërdor fondet financiare dhe ka pasoja të thella negative për zhvillimin ekonomik dhe atë social të vendit.

Ai rrezikon besueshmërinë e bashkëpunimit për zhvillim, mbështetjen e tij nga publiku dhe frenon përpjekjet e të gjithëve që angazhohen për të mbështetur zhvillimin afatgjatë, si dhe pengon konkurrencën e hapur dhe transparente, ndër të tjera lidhur edhe me çmimet dhe me cilësinë.

Të dyja qeveritë do të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën për të siguruar transparencë, dhënie llogarie dhe integritet gjatë përdorimit të fondeve publike dhe për të shmangur raste të mundshme ekzistuese të praktikave të korruptuara në bashkëpunimin për zhvillim.

Të dy delegacionet ranë dakord që konsultimet e ardhshme dhe bisedimet qeveritare 2003 të zhvillohen në Tiranë. Për afatet kohore do të bihet më vonë dakord.

Ky protokoll u hartua në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane.

Ky protokoll hyn në fuqi pas njoftimit me notë verbale të Palës Shiptare drejtuar Palës Gjermane mbi përfundimin e procedurave ligjore të miratimit të tij.

Tiranë, më 20 nëntor 2002

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë Adriana Berberi	Për delegacionin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë Dr. Leo Kreuz

Përbërja e delegacionit shqiptar

Ministria e Ekonomisë	Znj. Adriana Berberi, Zëvendësministre Znj. Valbona Zeneli, Këshilltare Z. Aliosha Gjondedaj, Shef i Sektorit Bilateral Z. Gentian Beqiri, Koordinator i RFGJ-së
Ministria e Drejtësisë	Z.Alion Cenolli, Drejtor i Përafrimit të Legjislacionit
Ministria e Industrisë dhe Energjetikës	Z. Fatjon Tugu, Znj. Etleva Rustemaj
Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	Z. Arben Molla, Drejtor i Programeve Bujqësore
Ministria e Punëve të Jashtme	Z. Gazmend Turdiu, Drejtor i Drejtorisë së Vendeve anëtare dhe pranë BE-së. Znj. Valentina Yli, specialistë pranë kësaj Drejtorie
Ministria e Financave	Znj. Mimoza Loli, shefe e Borxhit të Jashtëm dhe Financimeve të Huaja.
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Z. Maksim Mitrojorgji, Drejtor Ekzekutiv i FSHZH
Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.	Znj. Rovena Haxhihasta, specialiste në Drejtorinë e Integrimit Evropian dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
Ministria e Shtetit për Integrimin	Znj. Valbona Kuko, Drejtore e Departamentit të Integrimit
Ministria e Shëndetësisë	Z. Fatmir Brahimi, Drejtor i Drejtorisë Spitalore. Z. Agim Shehu, Drejtor i Drejtorisë së Kujdesit Parësor
Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	Z. Genc Gjeci, Z. Roland Olli, Z. Sadetin Limani, Z. Bujar Rreme
Ministria e Arsimit	Z. Bashkim Muzaka
Enti Rregullator Ujërave	Z. Vladimir Meksi
Banka e Shqipërisë	Znj. Esmeralda Uruçi

Përbërja e delegacionit gjerman

Herr Dr. Leo Kreuz	Referatsleiter 204 im Bundesministerium fur wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung (BMZ)
Frau Irene Dibbern	Mitarbeiterin im Referat 204 im BMZ
Frau Sabine Bloch	Botschaftsrätin, Deutsche Botschaft Tirana
Herr Michael Dumke	Amtsrat, Deutsche Botschaft Tirana
Frau Dr. Marlis Sieburger	Abteilungsdirektorin, KfW
Herr Dr. Anton Wirth	Gruppenleiter Balkan, GTZ
Herr Piro Trebicka	Lokale Fachkraft der KfW
Herr Ismail Beka	Lokale Fachkraft der GTZ
Frau Doreida Kafexhiu	Dolmetscherin

V E N D I M
Nr. 692, datë 27.12.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 288, DATË 18.6.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË TELEKOMUNIKACIONEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi, në dokumentin e politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 288, datë 18.6.1999 të Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Ndryshimet në dokumentin "Politika e Zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë"

Pika 2 "Objektivat afatmesme", objektivi "Në vitin 2003 të rritet në 450 000-500 000 (që i korrespondon një penetrim telefonik rreth 15%) numri i linjave telefonike në punë në gjithë vendin", ndryshohet si më poshtë vijon:

"Në vitin 2005 të rritet në 450 000-500 000 (që i korrespondon një penetrim telefonik rreth 15%) numri i linjave fikse telefonike në punë në gjithë vendin".

Pika 3 "Struktura e tregut të telekomunikacioneve", paragrafi i shtatë, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Ky model i liberalizimit gradual, që i lejon operatorit kombëtar ekzistues një periudhë të kufizuar ekskluziviteti gjatë së cilës ai do të investojë dhe ribalancojë tarifat, është ndjekur edhe nga vendet e tjera evropiane. Qeveria parashikon që, pasi të jetë bërë një progres i konsiderueshëm me investimet në rrjetet vendore, urbane dhe rurale, si dhe të jenë rregulluar tarifat, të mundësohet liberalizimi i shërbimeve bazë".

Pika 4 "Privatizimi", paragrafi i pestë, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Si kompensim të angazhimeve për investimet e përshkruara më sipër, Albtelecom-it do t'i

jepet një e drejtë ekskluzive për të ofruar shërbime telefonike kombëtare e ndërkombëtare dhe shërbime telefonike lokale në zonat urbane bazuar në rrjetin e tij për një periudhë të paktën deri në 30 qershor 2003.

Ndërkohë do të ndërmerren të gjitha hapat e nevojshëm për të bërë të mundur që në fund të kësaj periudhe operatori Albtelecom të jetë i gatshëm për privatizim, si dhe do të përcaktohet plani i veprimit për liberalizimin e plotë të tregut të telekomunikacioneve".

Pika 8 "Politika e licensimit për shërbimet publike", paragrafi i tretë, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Procedurat e licensimit do të zbatohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Qeveria do të përcaktojë numrin e licencave që do të jepen për shërbimet e klasifikuara në kategorinë e parë të tabelës së përmendur më sipër. Edhe me hapjen e plotë të tregut të telekomunikacioneve për konkurrencë, disa shërbime do të vazhdojnë të ekzistojnë në këtë kategori, ku numri i licencave është i kufizuar. Një klasifikim i tillë do të bëhet për ato shërbime që përdorin burime të kufizuara natyrore, siç janë frekuencat. Në këtë rast, ERT do të ndërmarrë studimin e brezave të frekuencave që janë caktuar për përdorim nga shërbimet publike të telekomunikacioneve me destinacion lidhjen e përdoruesve me pajisjet kumtuese, konform përcaktimeve të Planit Kombëtar të Radiofrekuencave dhe rekomandimeve ndërkombëtare, dhe brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2003 do të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave kriteret dhe procedurat e licencimit".

Në tabelën e aneksit 1 "Klasifikimi i shërbimeve të telekomunikacioneve për qëllime licencimi", rreshti i dytë i klasës A "Shërbime telefonike kombëtare", kolona e tretë, "Komente mbi procedurat e licencimit", ndryshon si vijon:

"Vetëm Albetelekom (të paktën deri në 30 qershor 2003)"

në klasën A "Shërbime telefonike kombëtare" shtohet rreshti si vijon:

	3. Kombëtare dhe lokale	
	Shërbime publike fikse, që përdorin teknologjinë pa tela, të njohura me termin "rrjeti lokal pa tela"	Albtelekom, të tjerët me tender të hapur ndërkombëtar

Në aneksin 2 "Glosari i termave të telekomunikacioneve të përdorur në këtë politikë", shtohet ky përkufizim:

Rrjeti lokal pa tela	Lidhja(et) e përdoruesve në rrjetin e telekomunikacioneve, jo nëpërmjet kabllove, por nëpërmjet shfrytëzimit të pajisjeve radio.

V E N D I M
Nr. 695, datë 27.12.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 766, DATË 8.12.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE USHTARAKE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË"

Në mbështetje të nenit 100 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8487, datë 13.7.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në paragrafin e dytë të pikës 1, afati "…deri në 31.12.2002" zëvendësohet me "…deri në 31.12.2003".

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Pagesën e gatishmërisë e përfitojnë 900 punonjës të kombinatit mekanik në Poliçan, 60 punonjës të uzinës së lëndëve plasëse në Elbasan, 70 punonjës të uzinës mekanike në Gramsh, 20 punonjës të uzinës së pilave në Gramsh dhe 50 punonjës të uzinës së riparimit të aviacionit në Kuçovë".

c) Në fund të pikës 4 pas fjalës "…papunësie" të shtohet fjalia "Këta punonjës nuk përfitojnë nga rritja e pagave të punonjësve buxhetorë për vitin 2003.".

2. Fondi prej 169 000 000 (njëqind e gjashtë dhjetë e nëntë milionë) lekësh, i nevojshëm për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga fondet e miratuara për vitin 2003, për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

U D H Ë Z I M
Nr. 1/1, datë 17.12.2002

PËR KRITERET E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 666, DATË 26.10.1998 "PËR DISA MASA LIDHUR ME PROCESIN E LIKUJDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VARTËSISË SË ISH AGJENCISË QENDRORE TË RISTRUKTURIMIT DHE PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJEVE BUJQËSORE"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 26.10.1998, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit,

U D H Ë Z O J N Ë:

1. Debitorët e krijuar në ndërmarrjet e vartësisë së ish AQRP-së, NB-ve, nga shitja e pasurisë shtetërore me këste sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 26.10.1993, detyrimet financiare të pashlyera do t'i paguajnë 100 për qind me lekë, të pa indeksuara me indeksin e çmimeve.

Për objektet, privatizimi i të cilëve është ndërprerë nga shkrirja e ish AQRP-së, NB-ve, dokumentacioni i privatizimit do të plotësohet ose përgatitet nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit e rrethit përkatës e cila e dërgon atë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, që këtej në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit dhe kjo e fundit në Degën e AKP-së për lidhjen e kontratës së shitblerjes.

2. Debitorët privatë, të krijuar nga vlera e paradhënieve kulturale në bujqësi, për vlerën e vreshtave, agrumeve, ullinjve dhe drufrutorëve të tjerë, si efekt i shpërndarjes së tokave nga ish ndërmarrjet bujqësore, t'i paguajnë detyrimet financiare me bono privatizimi, letra me vlerë, ose me lekë pa u indeksuar këto detyrime financiare me indeksin e çmimeve.

3. Debitorët privatë, të krijuar nga shpërndarja e kafshëve, automjeteve, traktorëve, makinerive dhe pajisjeve të ndryshme bujqësore të ish NB-ve, shumat e papaguara t'i shlyejnë me letra me vlerë, ose bono privatizimi pas indeksimit me indeksin e çmimeve të mallrave të konsumit.

4. Të gjithë debitorët privatë, krijuar nga vlera e objekteve ndërtimore të kontabilizuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 15.8.1994 ose në rastet e tjera të konstatuara për periudhën e mëvonshme, detyrimet financiare t'i paguajnë 100 për qind në lekë. Vlera e çdo objekti ose pjesë e tij do të llogaritet sipas kreut I, paragrafi i parë dhe pikës 1 paragrafi i parë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998, (vlera kontabël e mbetur korrigjohet si me koeficientin e indeksit mujor ashtu edhe me atë të vendndodhjes).

5. Kontratat e shitjes së objekteve, të lidhen nga degët e AKP-së në rrethet përkatëse, sipas dokumentacionit të përgatitur nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit i cili kalon në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencinë Kombëtare e Privatizimit. Kjo e fundit e dërgon atë, në Degët e AKP-së së rrethit përkatës.

6. Arkëtimi i detyrimeve financiare nga shitja e pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve bujqësore që bëhet në lekë, 5 për qind të vlerës të arkëtuar të derdhet në favor të AKP-së.

7. Debitorët privatë, të krijuar nga marrja e paradhënieve për shërbime dhe të pakthyera nga paga e dieta të marra padrejtësisht, për vjedhje, shpërdorime e përvetësime, etj., të kësaj natyre, për të cilat ekziston dokumentacion i plotë ligjor, detyrimet financiare t'i shlyejnë 100 për qind me lekë dhe të indeksuara me indeksin e çmimeve të muajit paraardhës në të cilin bëhet pagesa.

8. Debitorët dhe kreditorët shtetërore ose në persona, që aktualisht ndodhen të regjistruar në kontabilitetin e ndërmarrjeve të vartësisë së ish AQRP-së të NB-ve dhe janë pa shpresë arkëtim/pagese, (pika 2,3,7 e këtij udhëzimi) të mbyllen.

9. Privatizimi i pasurisë shtetërore, i ndërmarrjeve të varësisë së ish AQRP-së të NB-ve, e cila aktualisht është e pa privatizuar dhe e pazaptuar, të bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.197, datë 20.3.1998 dhe ndryshimeve të mëvonëshme të tyre.

10. Për probleme të veçanta që mund të dalin nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 26.10.1998 të cilat nuk janë trajtuar në këtë udhëzim, për çdo rast do të veprohet me urdhër të veçantë të lëshuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

11. Udhëzimi nr.1, datë 23.2.1999 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi të jetë botuar në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit
Arben Duka

Ministri i Ekonomisë
Arben Malaj

	veçantë"…… …….	
Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 1/1, datë 17.12.2002	Për kriteret e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 26.10.1998 "Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të ndërmarrjeve bujqësore"……..……..…… …….	2748

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:



U dorëzua për shtyp më 22.1.2003
Doli nga shtypi më 23.1.2003

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë